



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

Numri i lëndës: 2020:150563

Datë: 12.06.2024

Numri i dokumentit: 05812048

KA.nr.789/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Administrative, gjyqtarja Vlora Pacolli-Rexhepi, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit “Mobelland”, me pronar R.M. me seli në Suharekë rr.Xhavit Sylja, kundër të paditurës Komuna e Suharekës me seli në Suharekë për shkak të anulimit të Vendimit 09 Nr.2054 të datës 15.10.2020, jashtë seancës, me datë 28.05.2024 merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. **HEDHET** padia e paditësit Mobilland me seli në Suharekë, kundër të paditurës Komuna e Suharekës me seli në Suharekë, për shkak të anulimit të Vendimit 09 Nr.2054 të datës 15.10.2020, **si e paplotësuar**
- II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta.

A r s y e t i m

Paditësi “Mobelland” me pronar R.M. me datën 04.11.2020 ka parashtruar padi, kundër të paditurës kundër të paditurës Komuna e Suharekës me seli në Suharekë, për shkak të anulimit të Vendimit 09 Nr.2054 të datës 15.10.2020

Gjykata pas shqyrtimit paraprak të padisë, gjykata konstaton se adresa e paditësi i ka parashtrësuar në adresën Rr. Xhavit Sylja Suharekë, mirëpo, e njëjta është kthyer në gjykatë me konstatim në raport “firma e panjohur”

Si rezultat i kësaj, gjykata me datë 27.05.2024 mori aktvendim me të cilin paditësit i’u kthye padia në plotësim, me detyrimin që ta njoftoj gjykatën për adresë të selisë në të cilën ushtron veprimtarinë, dhe të njëjtën e vendosi në tabelë të shpalljes, ku qëndroj 7 ditë.

Pas kalimit të afatit gjyqësor, gjykata konstaton se pala paditëse nuk i ka kryer veprimet procedurale si në aktvendimin e datës 27.05.2024 për plotësim të adresës.

Bazuar në Ligjin për Konfliktet Administrative, nenit 33 nenit 33, Nëse padia nuk është e plotë, është e pakuptueshme ose ka të meta, kryetari i kolegjit do të ftojë paditësin, që: *brenda afatit prej tetë (8) ditëve t’i mënjanojë të metat e padisë. Në ftesë duhet të ceken udhëzimet për të mënjeluar të metat e padisë dhe paralajmërimi për pasojat që do të lindin nëse nuk vepron sipas kërkesës së gjykatës, dhe Nëse paditësi, brenda afatit të cekur, nuk i mënjanon të metat e padisë, kurse ato janë të atilla që e pamundësojnë zhvillimin e procedurës, gjykata do ta hedhë poshtë me vendim padinë, nëse nuk konstaton se akti administrativ i kontestuar është i pavlefshëm, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi. Lidhur me shpenzimet procedurale gjykata vendosi në bazë të nenit 64 të LKA-së.*

Andaj, gjykata konsideron se nuk ka kushte për shqyrtimin e më tutjeshëm të padisë, dhe vendosi si në pikën I të këtij aktvendimi, duke e përfunduar procedurën në këtë çështje administrative.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë Departamenti i Përgjithshëm

Ka.nr.789/22, datë 28.05.2024

Gjyqtarja
Vlora Pacolli Rexhepi

KËSHILLA JURIDIKE : Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita e pranimi të aktvendimit, në Dhomën e Shkallës së Dytë në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.